

MARREVESHJE MES SHKOLLAVE DHE PRINDERVE/KUJDESTAREVE PER PASTRIMIN E MORRAVE TE KOKES

(Insert school details)

Për disa prindër/kujdestarë, mësues dhe fëmijë, morrat e kokës vazhdojnë të shkaktojnë shqetësime dhe mërzi. Morrat e kokës nuk transmetojnë sëmundje infektive – ata transmetohen nëpërmjet kontaktit me kokën e dikujt që ka morra koke. Megjithatë përgjegjësia kryesore për gjetjen dhe trajtimin e morrave të kokës i bie prindit, kontrollimi dhe pastrimi i morrave të kokës është një përgjegjësi që mbahet prej një numri të caktuar agjesh, duke përfshirë Departamentin e Arsimit dhe Trajnimit, Departamentin e Shërbimeve Civile, shkollën dhe prindërit. Departamenti i Arsimit dhe Trajnimit ka për detyrë që t'u japë shkollave këshilla dhe ndihmë në lidhje me pastrimin e morrave të kokës.

Kjo marrëveshje përmbledh:

- Përgjegjësitë e shkollës dhe të prindit/kujdestarit;
- Rëndësinë e metodikës me disa drejtime për të marrë të gjitha masat që problemit të morrave të kokës t'i jepet një zgjidhje e mirë dhe efikase.

Përgjegjësitë

Prindi/Kujdestari – përgjegjësitë përfshijnë:

- Kontrollimin e rregullt të flokëve të fëmijës (mundësisht një herë në javë) për të parë në se ka morra ose thërija si dhe kontrollimin e rregullt të anëtarëve të tjerë të familjes dhe pastrimin e tyre në se është e nevojshme;
- Marrjen e masave që fëmija të mos e frekutojë shkollën në rast se ka morra koke;
- Përdorimin e kurave të parrezikshme të cilat nuk rrezikojnë shëndetin e fëmijës (shih Pamfletin *Trajtimi dhe Pastrimi i Morrave të Kokës*).
- Njoftimin e shkollës në rast se fëmija infektohet me morra koke si edhe njoftimin me anë të formularit *Masat e Marra*, në se është filluar ose jo pastrimi;
- Njoftimin e prindërve dhe kujdestarëve të shokëve të fëmijës suaj që edhe ata të kenë mundësi që të pastrojnë fëmijët tyre në se është nevoja.

I kam lexuar dhe i marr përsipër përgjegjësitë e mësipërme:

Nënshkrimi i prindit/kujdestarit: **Data**.....

Nënshkrimi i prindit/kujdestarit: **Data**.....

Shkolla – përgjegjësitë përfshijnë:

- Shpërndarjen e rregulloreve dhe informacioneve për zbulimin, trajtimin dhe pastrimin e morrave të kokës për prindërit/kujdestarët. Gjithashtu marrjen e masave që kolektivi i shkollës të njohë dhe të ketë protokollet e posaçme për programin e kontrollimit që ka ndërmarrë shkolla;
- Zbatimin e rregullores së shkollës për morrat e kokës e cila thekson mbajtjen në kontroll të vazhdueshëm dhe të saktë të morrave të kokës, rregullore e cila është aprovuar prej shkollës;
- Marrjen e lejes prej prindërve në lidhje me kontrollimin për morrat e kokës, ditën e regjistrimit të fëmijës në shkollë. Kjo leje vlen për të gjithë periudhën shkollore të kaluar në atë shkollë. Shkolla, nëpërmjet Drejtorit dhe Këshillit të Shkollës, ka për detyrë caktimin e një personi me përvojë për të kryer kontrollimin e morrave të kokës;
- Inkurajimin e personave përgjegjës për kontrollimin, p.sh mësuesit, që në se dyshojnë për praninë e morrave të kokës, t'a bëjnë kontrollin vetëm me sy, d.m.th pa patur kontakt fizik me fëmijën;
- Inkurajimin e prindërve/kujdestarëve që të vazhdojnë kontrollimet rregullisht (mundësisht një herë në javë) si dhe t'u japë atyre këshilla pa paragjyqime sidomos atyre prindërve që kanë vështirësi me masat e kontrollit;
- Inkurajimin e nxënësve për të mësuar për morrat e kokës në mënyrë që në shkollë të mos ketë paragjyqime për këtë çështje;
- Njohjen e rregullit që ka të bëjë me përgjegjësinë për përjashtimin e një fëmije nga shkolla. Kjo përgjegjësi i takon drejtorit të shkollës ose personit drejtues. Përjashtimi nga shkolla ka të bëjë vetëm me morrat e kokës dhe jo me thërijat e tyre; nxënësit duhet të përjashtohen vetëm pas mbarimit të ditës së shkollës dhe atyre duhet t'i jepet një shënim që duhet t'i jepet prindit për t'a informuar që fëmija ka morra koke.
- Informimi që sipas *Rregullores Shëndetësore 2001 (Sëmundjet Infektive)* fëmija i kuruar për morra koke nuk është i detyruar që të marrë vërtetim nga mjeku patolog apo bashkia e qytetit para kthimit në shkollë.
- Kur duhet dhe sipas vendimeve të drejtorit dhënia e njoftimeve për gjetjen e morrave të kokës tek komuniteti shkollor;
- Inkurajimin e prindërve/kujdestarëve që të gjejnë kurat e duhura, datën e fillimit të trajtimit duke përdorur *Formularin MASAT E MARRA*.

(insert name of school) është e vendosur që të trajtojë problemin e morrave të kokës me kujdes dhe ndjeshmëri. Ne do t'i përmbahemi të gjitha përgjegjësiave të mësipërme.

Nënshkrimi i Drejtorit **Data**.....

Albanian-Head Lice Management Agreement